

KONKORDANCAT DHE FJALËT-ÇELËS TË POEZISË SË NDRE MJEDËS

CONCORDANCES AND KEY-WORDS IN THE POETRY OF NDRE MJEDA

Nebi CAKA*, Ali CAKA**

*Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike,
Universiteti i Prishtinës, Kosovë
Email: nebi.caka@fiek.uni-pr.edu

**Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i Prishtinës, Kosovë

Përmbledhje

Edhe pse kanë kaluar 50 vjet nga konkordancat e para të nxjerra me anë të kompjuterit, ato ende konsiderohen si një mjet i rëndësishëm në shumë kërkime shkencore. Mundësia, që më lehtë se kurrë, të kemi në dispozicion një numër të madh tekstesh në formë elektronike e ka riaktualizuar përdorimin e konkordancave kompjuterike, sidomos për analizën dhe studimin e korpuseve tekstore të ndryshme dhe të veprave të autorëve të ndryshëm. Në këtë aspekt, rëndësi të posaçme paraqesin veprat letrare të autorëve të njohur. Njëri ndër ta, për ne shqiptarët, pa mëdyshje, është edhe poeti Ndre Mjeda.

Ky punim për temë ka analizën leksikore-stilistike të poezisë së Ndre Mjedës me anë të metodave të gjuhësisë kompjuterike. Për këtë qëllim është përdorur një program kompjuterik,

i njohur si konkordancier, i cili na ka mundësuar të nxjerrim jo vetëm fjalësin e fjalëve të përdorura në vjershat e Mjedës, por edhe konkordancat e tipit *fjalët-çelës në kontekst* (KWIC) në to. Në bazë të dendurisë së paraqitjes së fjalëve të përdorura në vjershat e marra në shqyrtim (e janë marrë për shqyrtim po thuajse të gjitha vjershat e botuara të Mjedës, për së gjalli dhe pas vdekjes së tij) dhe të përndarjes së fjalëve nëpër vjersha dhe në bazë të konkordancave, është nxjerrë një listë fjalësh-çelës, të cilat, sipas mendimit tonë, mund të merren si fjalë-çelës të tërë poezisë së tij.

Fjalët-çelës: konkordancat kompjuterike, korpuset tekstore, Ndre Mjeda, analiza leksikore-stilistike, poezia, metodat e gjuhësisë kompjuterike, konkordancier, KWIC, fjalët-çelës.

1. Hyrje

Në fillim disa fjalë për termat a notionet *konkordancë* dhe *fjalë-çelës*.

Këtu me *konkordancë* kuptojmë jo bashkëpërkimin (siç është, bie fjala, ndërmjet dy gjuhëve, p.sh. bashkëpërkimet shqiptare-rumune), por renditjen alfabetike të të gjitha fjalëve të një veprë, me të gjitha kontekstet në të cilat ato paraqiten.

Përpilimi i konkordancave zë fill në shekullin XIII-të në studimet e Biblës, si nevojë për të krahasuar të gjitha kontekstet e së njëjtës fjalë. Deri te shfaqja e kompjuterit, ajo ka qenë një punë jo e lehtë, meqë është bërë me dorë. Me gjithë vështirësitë e përpilimit të konkordancave, për to kanë treguar interesim jo vetëm teologët, por edhe kritikët e letërsisë dhe kjo i ka dhënë hov zhvillimit të metodave për përpilimin e tyre.

Sot ka mjaft studiues që merren me përpilimin e konkordancave të veprave letrare të autorëve të ndryshëm, madje edhe krijojnë programe të posaçme kompjuterike për këtë qëllim [5]. Përpjekje të hartimit të konkordancave të veprave, sidomos të poezive, kemi edhe për autorët shqiptarë [4, 9].

Me *fjalë-çelës* (angl. *key words*; fr. *mots-clés*; gj. *Schlüsselwort*, sp. *palabras clave*; it. *parola chiave*, sk. *ključne riječi*), ndërkaq, nënkuptojmë ato fjalë që kanë një denduri të lartë të paraqitjes në tekstin a korpusin që shqyrtohet, krahasuar me një normativ. Si normativ rëndom merret korpusi themelor i një gjuhe.

Ne, këtu, si korpus themelor për shqipen kemi marrë "*Korpusin njëmljonfjalësh të gjuhës shqipe*" ("*Korpusi Caka*"), të cilin e kemi përpiluar (më 2006) sipas metodologjisë së përpilimit të korpusit të Braunit [13], me disa modifikime të vogla.

Për përpilimin e këtij korpusi është grumbulluar një material i shkruar mjaft heterogjen (i larmishëm) i teksteve në gjuhën shqipe, të krijuara ose të botuara për herë të parë në harkun kohor 1976-2006, pjesa më e madhe pas vitit 2000, nga hapësira gjuhësore mbarëshqiptare, nga i cili janë përfshirë 500 mostra me nga 2000 fjalë (a pak më shumë) a gjithsej 1.000.000 fjalë (në rastin konkret: 1.084.396). Në këtë korpus përfaqësohen zhanre a gjini të ndryshme, të cilat mund të grupohen në pesë nënkorpuse: mostra tekstesh nga letërsia artistike – proza letrare; mostra tekstesh nga shtypi i shkruar – proza informative; mostra tekstesh nga dramat, pjesët teatrore dhe regjistrimet e mbledhjeve – zëvendësim për "gjuhën e folur"; mostra tekstesh nga letërsia shkencore dhe edukative-arsimore – proza shkencore-edukative; mostra tekstesh nga legjislatoni dhe administrata – gjuha zyrtare [3, 4].

Fjalët, pastaj, janë *lematizuar*, d.m.th. janë sjellë në një trajtë të përbashkët, në trajtën që do ta kërkonim në fjalor. Kështu, b.f., trajtat emërore: *mal, mali, malit, i malit, e malit, të maleve, së maleve, malin, malet, maleve, i maleve, e maleve, së maleve, të maleve, malesh* – janë përfaqësuar me lemën *mal*. Ngjashëm tra-

jtat foljore: *shkoj, shkon, shkojmë, shkojnë, shkova, shkoi, shkoshe, shkote, shkoshin, kam shkue, ke shkue, kish shkue, shko, t'shkoj, t'shkoshe, do t'shkojmë, do të shkoshin, po shkon, po shkoni, me shkue, ke me shkue, tui shkue* etj. – janë përfaqësuar me lemën **shkoj**.

Nocionin e *fjalëve-çelës a fjalëve-kyçe*¹, siç quhen ndryshe, do të duhej ta dinin madje edhe nxënësit e klasës së tetë, bazuar në një test konkurrimi për nxënësit që do të regjistrohen në kl. IX, ku shkruan: “Shkruaj një tregim ku të përdoren fjalët kyçe: *verë, bregdet, det i qetë, gjelbërim, rrezik, notar, ndihmë e shpejtë*” [Shkolla jopublike Nr. 1. Vlorë, viti shkollor 2006–07].

Për fjalët-çelës interesohen jo vetëm gjuhëtarët. Sot, madje, ka shkencëtarë, si profesori Moshe Koppel dhe kolegët e tij nga Departamenti i Informatikës në Universitetin Bar-Ilan të Israelit që pohojnë se mund të caktojnë gjininë (seksin) e autorit të një shkrimi në bazë të 566 fjalëve-çelës në anglishte. Sipas tyre, meshkujt u japin përparësi fjalëve që kategorizojnë dhe kuantifikojnë, kurse femrat parapëlqejnë fjalët që nënkuptojnë një marrëdhënie (relacion) dhe një personalizim (individualizim). [7].

2. Korpusi leksikor i poezisë së Ndre Mjedës

Si korpus leksikor i poezisë së Mjedës është marrë korpusi i përpiluar nga autorët në bazë të poezive të përfshira në Përmbledhjen e veprës së tij,

botuar nga Shtëpia botuese “Rilindja” e Prishtinës, më 1982 [11, 12].

Janë marrë për shqyrtim gjithsej 100 vjersha (29 me strofa treshe, 517 me strofa katërshe, 85 me strofa gjashtëshe dhe 25 me strofa shtatëshe), me gjithsej 2.840 vargje:

Vaji i bylbylit (64+56+56+52 = 228 vargje); *I tretuni* (64+42+48+72+60 = 286); *Andrra e jetës* (gjithsej 288 vargje: *Trina*: 28+56+16 = 100; *Zoga*: 32+48+40+16 = 136; *Lokja*: 24+28 = 52); *I mbetuni* (48); *Shtegtari* (56); *Vorri i Skanderbeut* (70); *Mahmut Pasha në Mal të Zi* (112); *Musatafa Pasha në Babune* (52); *Malli për atdhe* (52); *Giuha shqype* (92); *Prendvera* (20); *Vera* (16); *Vjeshta* (16); *Dimni* (12); *Vaji i dallëndyshës* (42); *Vllavras* (44); *Të vorruemit e sir John Moore* (48); *Mbreti i Tulës* (24); *Anderr* (16); *Shqypes arbnore* (60); *Bashkonju* (52); *Per një shkolle shqype mbyllun prej qeveris otomane* (48); *Mikut tem Pal Moret-it S. J.* (64); *Mikut P. Moret-it S. J.* (56); *Në dekë të shoqit tem Gj. S.* (78); *Vjollces* (16); *Nji shoqit qi kthehet në Shqypni* (105); *Uzdaja pa dobi* (48); *Iliria e Epiri: Lissus* (104); *Lirija* (6 x 14 = 84); *Lissus* (12 x 14 = 168); *Scodra* (11 x 14 = 154); *Guxo!* (8); *Luani* (8); *Ujku* (32); *Rrena* (12); *Kallxit* (9); *Nji qortim* (16); *Thnegla e pëllumbi* (12); *Puna* (16); *Kanga e gjelit* (12); *Puna* (12); *Dashtnija ndaj prinden* (12); *Ndera e fëmijvet për mjeshttra* (16); *Nana me buzë në gaz* (12); *Shpis seme* (16); *Klluka* (12); *Vera* (12); *Zambaku* (16); *Dallëndyshes* (12); *Agimi* (8); *Kashë e lasha* (gjithsej 38): *Hana* 6, *Rrufeja* 4, *Era* 6, *Jehona* 4, *Ora* e

murit 4, Qiriu 4, Kova 4, Fjalë të urta 6.

Shpresojmë se vjershat që nuk janë përfshirë në këtë Përmbledhje, pra as në analizën tonë, t'i vërtetonin gjetjet dhe konstatimet tona.

3. Fjalët-çelës të poezisë së Ndre Mjedës

Poezia e Ndre Mjedës ka qenë objekt studimi i shumë studiuesve, si M. Gurakuqi [8], S. Hamiti [9], R. Qosja [14], M. Quku [15] etj., – të përmendim vetëm disa, pa ndonjë theksim të veçantë të asnjërit prej tyre. Të gjitha këto studime, vështruar si tërësi nga një kënd i caktuar, na japin tablonë e interpretimit të poezisë së Mjedës. Punimi ynë, nuk është asgjë tjetër veçse një përpjekje që të ndërplotësohet ky mozaik.

Punimit i ka paraprirë, siç u tha edhe më lart, përfshirja elektronike e vjershave të marra në shqyrtim dhe le-

matizimi i fjalëve të tekstit të përftuar në këtë mënyrë. Pastaj, duke përdorur konkordancierin, është nxjerrë lista e tërë fjalëve të përdorura në vjershat e marra në shqyrtim dhe janë përpiluar (nxjerrë) konkordancat e plota të të gjitha fjalëve të kësaj liste.

Për nxjerrjen e fjalëve-çelës, nga lista e gjithmbarshme e përftuar me konkordancier janë hequr fjalët shërbyese (parafjalët, lidhëzat e pjesëzat), ndajfoljet dhe përemrat e numërorët, si dhe foljet *jam* e *kam* (me të gjitha trajtat e tyre) dhe pastaj nga lista, kështu e përftuar, janë hequr edhe fjalët me më pak se 10 paraqitje.

Nëse nga rang-lista e mësipërme i heqim fjalët neutrale, si: *shkoj, dal, lëshoj, shof, them, rri, vij, ndij, pres (me pritë), la (me lanë), marr, çoj (= dërgoj), baj (me ba), ndrroj*, dhe si **fjalë-çelës** i marrim 30 fjalët e para të listës të përftuar

Lista e fjalëve me më shumë se 9 paraqitje:

Nr.	Fjala	Gjithsej
1.	<i>Mal</i>	72
2.	<i>Shpi</i>	61
3.	<i>Zëmër</i>	61
4.	<i>Shkoj</i>	58
5.	<i>dal (me dalë)</i>	57
6.	<i>Fushë</i>	51
7.	<i>lëshoj (me lëshue)</i>	51
8.	<i>Shof</i>	51
9.	<i>Nanë</i>	43
10.	<i>them (me thanë)</i>	43
11.	<i>Ditë</i>	42

38.	<i>Shqypni</i>	26
39.	<i>Atdhe</i>	25
40.	<i>baj (me ba)</i>	25
41.	<i>Fëmijë</i>	25
42.	<i>Gëzoj</i>	25
43.	<i>Lule</i>	25
44.	<i>Ndrroj</i>	25
45.	<i>qiell (qiellë)</i>	25
46.	<i>madh (i) / madhe (e)</i>	24
47.	<i>Gjimoj</i>	23
48.	<i>kqyr (me kqyrun)</i>	23
49.	<i>Mizuar</i>	23

Konkordancat dhe fjalët-çelës të poezisë së Ndre Mjedës

12.	<i>rri (me ndejun)</i>	42
13.	<i>vij (me ardhë)</i>	42
14.	<i>Vënd</i>	41
15.	<i>ndij (me ndi)</i>	39
16.	<i>Vaj</i>	37
17.	<i>Dritë</i>	36
18.	<i>Bylbyl</i>	35
19.	<i>Det</i>	35
20.	<i>mjerë (i, e)</i>	35
21.	<i>pres (me pritë)</i>	34
22.	<i>huej (i, e)</i>	33
23.	<i>shqype (shqypja)</i>	32
24.	<i>Vorr</i>	32
25.	<i>la (me lanë)</i>	31
26.	<i>zâ (zâni)</i>	31
27.	<i>marr (me marrë)</i>	30
28.	<i>Erë</i>	29
29.	<i>Natë</i>	29
30.	<i>Tokë</i>	29
31.	<i>shkret (i, e)</i>	28
32.	<i>Kendoj</i>	27
33.	<i>Sy</i>	27
34.	<i>çoj (= dërgoj))</i>	26
35.	<i>Dhë</i>	26
36.	<i>Diell</i>	26
37.	<i>Dorë</i>	26

76.	<i>ushtoj (me ushtue)</i>	19
77.	<i>Breg</i>	18
78.	<i>Dallëndyshe</i>	18
79.	<i>Filloj</i>	18
80.	<i>Hânë</i>	18
81.	<i>mbëloj (me mbëlue)</i>	18
82.	<i>nisem (me u nisë)</i>	18
83.	<i>ri (i) / re (e)</i>	18

50.	<i>Shënd</i>	23
51.	<i>Djalë</i>	22
52.	<i>Gjak</i>	22
53.	<i>Kângë</i>	22
54.	<i>bie (me ramun)</i>	21
55.	<i>çilet (me u çel)</i>	21
56.	<i>di (me dijtë)</i>	21
57.	<i>Fis</i>	21
58.	<i>Hije</i>	21
59.	<i>Jetë</i>	21
60.	<i>Lyp</i>	21
61.	<i>Mot</i>	21
62.	<i>Shqyptar</i>	21
63.	<i>due (me dashtë)</i>	20
64.	<i>Gjuhë</i>	20
65.	<i>Krye</i>	20
66.	<i>Ngreh</i>	20
67.	<i>Fatos</i>	19
68.	<i>gjej (me gjetun)</i>	19
69.	<i>jes (me jetun)</i>	19
70.	<i>Kâmbë</i>	19
71.	<i>Kërkoj</i>	19
72.	<i>Maje</i>	19
73.	<i>mner / mnershëm</i>	19
74.	<i>Ndal</i>	19
75.	<i>Shpatë</i>	19

115.	<i>kujtoj (me kujtue)</i>	13
116.	<i>Liri</i>	13
117.	<i>Lulzon</i>	13
118.	<i>Punë</i>	13
119.	<i>Shkâmb</i>	13
120.	<i>Thërras</i>	13
121.	<i>Trim</i>	13
122.	<i>Vajtoj</i>	13

NEBI ÇAKA, ALI ÇAKA

84.	<i>Zog</i>	18
85.	<i>Anmik</i>	17
86.	<i>Borë</i>	17
87.	<i>Drin</i>	17
88.	<i>Ilir</i>	17
89.	<i>Rrugë</i>	17
90.	<i>Valë</i>	17
91.	<i>vej (me vu)</i>	17
92.	<i>Bjeshkë</i>	16
93.	<i>kjaj (me kjamun)</i>	16
94.	<i>Lot</i>	16
95.	<i>Luftë</i>	16
96.	<i>Prendverë</i>	16
97.	<i>Shqiptari</i>	16
98.	<i>siell (me sjellun)</i>	16
99.	<i>Ushtri</i>	16
100.	<i>Vlla</i>	16
101.	<i>Votrë</i>	16
102.	<i>Ankim</i>	15
103.	<i>Burrë</i>	15
104.	<i>Buzë</i>	15
105.	<i>Fjalë</i>	15
106.	<i>Nieri</i>	15
107.	<i>Skanderbeg</i>	15
108.	<i>Diftoj</i>	14
109.	<i>Komb</i>	14
110.	<i>Shndrit</i>	14
111.	<i>des (me dekun)</i>	13
112.	<i>fal (me falun)</i>	13
113.	<i>Flakë</i>	13
114.	<i>Gazmoj</i>	13
154.	<i>Shpirt</i>	10
155.	<i>Shtegtar</i>	10
156.	<i>Ujë</i>	10

123.	<i>vorfën (i, e)</i>	13
124.	<i>zi (i) /zezë (e)</i>	13
125.	<i>çohet (= ngritet)</i>	12
126.	<i>Gjytet</i>	12
127.	<i>Hyll</i>	12
128.	<i>Kohë</i>	12
129.	<i>Kopsht</i>	12
130.	<i>Lumni</i>	12
131.	<i>ndej (me ndejtun)</i>	12
132.	<i>punoj</i>	12
133.	<i>pushoj</i>	12
134.	<i>Rreze</i>	12
135.	<i>tret (me tretun)</i>	12
136.	<i>Trimni</i>	12
137.	<i>Bir</i>	11
138.	<i>Ferishte</i>	11
139.	<i>hap (me hapun)</i>	11
140.	<i>Hov</i>	11
141.	<i>Idhnim</i>	11
142.	<i>Lirim</i>	11
143.	<i>Luftoj</i>	11
144.	<i>lumi (i)</i>	11
145.	<i>Ul</i>	11
146.	<i>zbres (me zbrit)</i>	11
147.	<i>Çerdhe</i>	10
148.	<i>Dekë</i>	10
149.	<i>Fluturim</i>	10
150.	<i>Lis</i>	10
151.	<i>Lug</i>	10
152.	<i>mëni (mni)</i>	10
153.	<i>pyll (pyllë)</i>	10
158.	<i>zgjoj (me zgjue)</i>	10
159.	<i>Zot</i>	10
160.	<i>Zymbyl</i>	10

kështu, do të kemi këtë listë:

*mal, shpi, zëmër, fushë, nanë, ditë, vënd, vaj, dritë, bylbyl, det, mjerë (i, e), huej (i, e), shqype, vorr, zâ, erë, natë, tokë, shkret (i, e), kendoj, sy, dhë, diell, dorë, Shqypni, fëmijë, gëzoj, lule, qiell (qiellë)*².

Është interesant të shihen, po ashtu, fjalët e kësaj liste që në korpusin themelor renditen nën numrin rendor 1000, si p.sh.:

bylbyl (4140), *dallëndyshe* (8197), *borë* (1823), *çil* (1556), *lot* (1359), *prendverë* (1377), *fatos* (1646), *hanë* (1096), *flutroj* (1448), *kjaj* (1126), *lulëzoj* (3054), *kopsht* (1659), *vajtoj* (3590), *idhnim* (4177), *përmallshem* (i, e) (12386), *fluturim* (2580), *lulzim* (3148), *shqyptari* (3474), *morde* (11999), *gazmend* (2639) etj.

Sipas këtij kriteri, edhe këto fjalë do të mund të merreshin po ashtu si fjalë-çelës të poezisë së Ndre Mjedës.

4. Shembuj konkordancash

Shpi:

<i>Po merr rrugën me shkue n'</i>	<i>shpi,</i>	3494
<i>Gjithkush tregëtiet kthete nder</i>	<i>shpia</i>	2750
<i>Ku rrite motit lum</i>	<i>shpia e mretit</i>	2786
<i>Çdo krajl i madh nder</i>	<i>shpija.</i>	143
<i>Shurdh' a vendi e</i>	<i>shpija tytë;</i>	983
<i>Bëshin darsma neper</i>	<i>shpija,</i>	1136
	<i>Shpija e vogel qi dishron;</i>	1142
<i>T'mjer' shtegtarin</i>	<i>shpija e pret;</i>	1147
	<i>Shpija e jote gadi mbërriti,</i>	1158
	<i>Shpija e jote qe flakron.</i>	1159
<i>Pá burrë te</i>	<i>shpija.</i>	1433
<i>Ktheni nder</i>	<i>shpija,</i>	3077
<i>Del, o bij' prej</i>	<i>shpijes</i>	923
<i>Me shtue gjan', me mbajtur</i>	<i>shpinë:</i>	3595
<i>Qi n' derë t'</i>	<i>shpis</i>	2101
	<i>Shpisë</i>	3735
<i>kendote nji</i>	<i>shpië</i>	453
<i>Sot i vorfni askund nji</i>	<i>shpië,</i>	1080
<i>Dit' e natë pá buk e</i>	<i>shpië</i>	1088

të poezisë së Ndre Mjedës

Në fund, po japim disa shembuj konkordancash të pesë fjalëve-çelës të para të poezisë së Ndre Mjedës, me numrin e vargut ku paraqiten ato, që sado pak ta shohim prej më së afërmi botën e Mjedës poet.

5. Përfundim

Metodat e gjuhësisë kompjuterike na mundësojnë që më thjeshtë dhe më saktë të përpilojmë listat e dendurisë të fjalëve të një teksti, sado i madh të jetë ai. Falë konkordancierit, mund të përpilojmë më lehtë edhe listën e fjalëve-çelës të një shkrimtari, dhe në bazë të kontekstit të këtyre fjalëve (KWIC) të përkapim kuptimin e tyre që na mundëson të bëjmë më lehtë edhe interpretimin e veprës së tij – të hymjë më lehtë në botën artistike të tij. Në këtë punim si objekt studimi është marrë poezia e Mjedës. Nga shembujt (jo të shumtë, për shkak të hapësirës) që jepen këtu,

NEBI ÇAKA, ALI ÇAKA

	Tui shpejtue per	shpië	qi don.	1144
	Pá mendue per	shpië	të vet:	1167
	Mbi	shpië	t' artë ku rri me mbret;	1568
	Afer	shpiës	s'eme hovin t'ënd ndale;	295
	Lerg	shpiës	e lerg gjith sendjit,	475
	M' buz' t'nji strehe o n' kulm t'	shtëpisë		3629
Zëmer:				
	Tui kqyrë me	zemer	t'plasun;	742
	M' thrrët, o Pal e n' ket	zemer	ldhnake	2208
	Ah s' di kandje kjo	zemer	e mjera!	2213
	Njiket	zemer	t'pafate ma shkreh;	2274
	E shpirt e	zemer	neper buz' i shtraze.	2877
	jé e gëzue në	zemer	bashkë me hyjt e qiellës qi u këqyrshin.	3189
	E n' at'	zemer	u knaqshe pá fë kobit,	3205
	t'dhimt' e	zemers	kúu s i pshtoj.	1900
	Pá daë ty	zemra	t' tretit	90
	Me t'lëshue kú	zemra	t' thrrët.	126
		zemra	me váj t' coptohet	130
	Ndoshta	zemra,	i mjeri, t' dhemb;	202
	E kurr	zemra	nuk ju dau.	219
	Qi kurr	zemra	si hatroj	330
		Zemra	per máll gazmohet,	963
	Per atdhë t'emín	zemra	po m'shkríhet;	1494
	Veç per ty' m' rreh	zemra	e mjera	1559
	Këtu mue	zemra	po m' vajton;	1833
	S' din atdhe	zemra	e dinakut;	2086
	Atëherë këto	zemra	t' mjera	2165
		Zemra	e eme mund t'presin galdim.	2221
	Dot'shkojm', si	zemra	ju don prej nesh.	3714
	Ktu	zemra	m' çilet,	3747
		Zemra	m' gazmon.	3750
		Zemra	s' ma ndrron.	3755
		Zemrat	të terhuza neper lamë nderimi.	3089
	Shkendín e	zembrave,	e i thau;	2118
	Geg' e Toskë nji	zemre	Jemi	2127
	Qi	zemren	ja gazmon.	116
	Bylbyl,	zemren	m'a copton;	162
	Vaji	zemren	ja pelset;	189
	Per gjithmonë	zemren	me n'a coptue;	236
	Por	zemren	moti jau ndrron tui shkue:	251
	Ká me t'a shëndoshun	zemren	gazmendi;	290
	Qi	zemren	t'a gazmon.	470
	Pá daë	zemren	m'a ngushllon.	1555
	E	zemren	u mundove	2152
	Qi	zemren	ja stolisin;	2365
	E kësaj	zemres	á pasqyra,	314
	E	zemres:	Shqiptarija.	2381
	Me t' gjak	zemres,	me krye pertrijë	1289
	Per mjedis te	zemres	s'ote,	620
	N'	zemrë	gjitmonë po pihe,	109
	N'	zemrë	nji gëzim m' pertrini	467
	N'	zemrë	pelset, i tretun	474
	Diç qi n'	zemrë	ká pá shfry?	557
	Mend e	zemrë	per te shkrij,	646
	Njajo flakë qi n'	zemrë	Pate	925
	T' pret nji	zemrë	flak' e shkendija,	928
	Me nji hov, me nji	zemrë	permbldhn'ju;	1278
	Me zhbi n' at	zemrë	t' vocerr	2155

Konkordancat dhe fjalët-çelës të poezisë së Ndre Mjedës

	<i>Mora</i>	zemër	<i>e e pveta me trimni:</i>	1982	
		<i>Në</i>	zemër	<i>Evropa mbelote;</i>	2313
		<i>Në</i>	zemër	<i>Perdhuni pritte;</i>	2333
	<i>Ju ma ndezt' një flak' në</i>	zemër		3688	
	<i>Mendje e</i>	zemër	<i>më lakmon.</i>	3691	
	<i>Kjo mende e vorfën, kjo</i>	zemër	<i>shkon;</i>	3697	
	<i>Por kemi 'j</i>	zemër;	<i>ani, kët ju,</i>	3708	
Mal e fushë:					
	<i>Qi per</i>	mal e fusha	<i>bje;</i>	338	
		Mal e fushë	<i>si n' kohë t' at hershme?</i>	550	
	<i>N'</i>	fush' e n' mal	<i>qi ti zotmon;</i>	1593	
	<i>E</i>	fushë e mal	<i>ushtoi: vojt Amerika</i>	2837	
	<i>Nder</i>	fush' e male	<i>janë tui flutruet:</i>	261	
	<i>Per</i>	fush' e male	<i>ku mendja m' vret:</i>	1509	
	<i>O bjeshk' o</i>	male, fusha	<i>t' bekueme,</i>	1518	
		Fush' e male	<i>kah kalote</i>	1780	
	<i>Nder</i>	fush' e male	<i>mungulloi Lirija.</i>	2881	
	<i>Kushtrimi i Kodrit nepër</i>	fushë e male:		3372	
		Fush' e male	<i>po lulzon.</i>	3850	
	<i>Prei</i>	fushësh e malesh	<i>Shqypartaria e, mote</i>	3127	
	<i>Gjith</i>	fushët e malet		15	
dhe:					
	<i>Kúr t' shkojsh nder</i>	fusha,	<i>kúr t' shkojsh nder</i>	male,	294
	<i>Neper</i>	male e neper	fusha		1116
	<i>Hap neper</i>	male e neper	fusha,		2096
	<i>Mbas një</i>	fushës e perte	malin		1146
	<i>Qi prei</i>	fushës per	gjys' e malin	<i>shkelte.</i>	3285
	<i>Prei majes t'</i>	malit	<i>shikoj lerg</i>	fushen	1513
Nanë:					
	<i>N' kâmb', o Shkodrë, o</i>	nan'	<i>e drangojve</i>	1272	
	<i>E</i>	nan	<i>bardha tui shikjue</i>	827	
	<i>Afer vorrit t'ând</i>	nan	<i>shkreta,</i>	611	
	<i>E</i>	nan	<i>zeza nuk pritote</i>	517	
		Nana	<i>e shkretë qi mbet pà djelm;</i>	172	
		Nana	<i>e jote à Shqypartaria.</i>	644	
	<i>Edhë</i>	nana	<i>i diq e ngrata,</i>	1070	
	<i>Mjerë</i>	nana	<i>tui dekun</i>	2597	
	<i>Mjerë</i>	nana,	<i>po rri.</i>	2610	
		Nana	<i>me buzë në gaz</i>	3717	
		Nanat	<i>e Hotit djelmanin ushtore,</i>	2919	
	<i>E i thirrshin</i>	nanat	<i>djelmanis kreshnike,</i>	3023	
	<i>Aje</i>	nanat	<i>shqyptare 'j dite do të shkoshin</i>	3131	
	<i>Ku kë</i>	nanen	<i>me dërdhë lot?</i>	1094	
	<i>Mue</i>	Nanen	<i>m' muer Deka</i>	2622	
	<i>Lamtumirë, o ti</i>	nanë	<i>shkreta</i>	352	
	<i>Vite lét te e mjera</i>	nanë,		514	
	<i>E kuvendte me</i>	nanë	<i>locen,</i>	807	
	<i>Ah!</i>	nanë	<i>shkreta! I shuemi briti,</i>	1852	
	<i>„Motër e</i>	nanë,	<i>tha, m' ke jam Shqypartaria”.</i>	1987	
	<i>„Fal me shëndet” m'i thuei</i>	nanës	<i>s'eme.</i>	571	
	<i>Afer</i>	nanës	<i>qi t' desht e t' ruejti;</i>	606	
	<i>Afer</i>	nanës	<i>u shtrua me fjetun,</i>	1103	
	<i>Qi fjalët e</i>	nanës	<i>belboshin</i>	2136	
	<i>N' prehen t'</i>	nanës	<i>me shkua kujton;</i>	1069	
	<i>N' prehen t'</i>	nanës	<i>tui gjetë pushim.</i>	1840	

edhe pa ndonjë shpjegim të veçantë mund të përkapet më lehtë vizioni poetik i tij.

Shënime

1. Autorët parapëlqejnë termin *fjalë çelës* kundrejt termit *fjalë kyç*, jo vetëm përshkak të etimologjisë sllave të fjalës *kyç*, por se mendojnë se fjala *çelës* e përcakton më mirë kuptimin e këtij togfjalëshi, meqë kemi të bëjmë me fjalë që shërbejnë si “çelës” për të çelur (hapur) portën hyrëse të veprës së një autori.

2. Nga krahasimi i këtyre 30 fjalëve me 30 fjalët e para të fjalësit të Lasgushit, të radhitura sipas dendurisë së paraqitjes në tekstin e poezive të tij (N. Caka, 1985): *zemër, mall, sy, shpirt, yll, këngë, lot, jetë, fund, gj, zjarr, dashuri, det, gas, zot, pikë, botë, qjell, mal, zë, fjalë, lule, dhe, erë, dritë, ças, përjetësi, i ri, i shkretë, qaj*; shohim se i kanë të përbashkëta 10: *mal, zemër, dritë, det, zë, erë, i shkretë sy, dhë, qiell*. Një krahasim i tillë do të ishte edhe më me interes po të bëhej me 30 fjalët “e para” të poezisë së Fishtes, Gurakuqit a Shirokës, bie fjala.

Bibliografia

1. B. Altenberg, S. Granger S. (eds) (2002) *Lexis in Contrast. Corpus-based Approaches. Studies in Corpus Linguistics 7*. Amsterdam & Philadelphia: Benjamins, 2002.

2. Catherine Ball, *Concordances and Corpora*, Corpus linguistic course, Department of Linguistics, Georgetown University, Washington DC, 1996, <http://www.georgetown.edu/ball/corpora/tutorial.html>.

3. Ali Caka, *Kontribut për fjalorin themelor të gjuhës shqipe* (Punim magjistrature, mentor: Rexhep Ismajli), Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 2007.

4. Nebi Caka, Ali Caka, *Korpusi njëmillionfjalësh i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 2006 (në përgatitje për botim).

5. Nebi Caka, *Analizë statistike dhe stilistike e gjuhës së Lasgush Poradecit* (Punim magjistrature, mentor: Rexhep Ismajli), Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik, Prishtinë, 1985.

6. Sanda Cherata, *CONCORD - Software System for Concordances of Romanian Poetical Texts*- Tufis, Dan and Andersen Poul, 1997, *Recent Advances in Romanian Language Technology*.

7. Elsa Fayner, *Informatique. Le sexe des auteurs*, L’hebdomadaire, Le Point du vendredi, 1^{er} août 2003, N° 1611.

8. Mark Gurakuqi, *Mbi veprën poetike të Mjedës*, në: “Ndre Mjeda: Vepra 3”, Rilindja, Prishtinë, 1982.

9. Sabri Hamiti, *Ndre Mjedja poet*, në: “Ndre Mjeda: Vepra 1”, Rilindja, Prishtinë, 1982.

10. Francisco Iusi, *Konkordancat elektronike të teksteve letrare*, Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë, Konferencë shkencore, Tiranë, 3 dhjetor 2004.

11. Ndre Mjeda, *Vepra 1 (Juvenilia; Vjersha të tjera; Lirija, Lissus; Scodra)*, Rilindja, Prishtinë, 1982.

12. Ndre Mjeda, *Vepra 2 (Vjersha për të vegjëll, Kashe e lasha)*, Rilindja, Prishtinë, 1982.

13. Francis W. Nelson, Henry Kucera, *Brown corpus manual of information (Manual to accompany A Standard Corpus of Present-Day, Edited American English, for use with Digital Computers)*, Brown University, 1964.

14. Rexhep Qosja, *Historia e letërsisë shqipe III – Romantizmi*, Rilindja, Prishtinë, 1986.

15. Mentor Quku, *Mjeda 1-7, Shb “Ilar”*, Tiranë 2004-2005.